




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Punëdhëni/Prodato Received/Delivered	02 - 02 2023	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SLUŽBA	1217 / 2023		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1215/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1215/2022 të datës 19.12.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me numër:166/2022 të datës 25.11.2022 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.02.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1215/2022 e datës 19.12.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anullohet Vendimi Nr:166/2022 i datës 25.11.2022 i Kryetarit të Komunës së Kamenicës.
- III. Detyrohet Kryetari i Komunës së Kamenicës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh, duke e aprovuar kërkesën e ankueses të datës 11.11.2022 për pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej një (1) viti.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesja, e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Komunën e Kamenicës, me datë 19.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër:166/2022 të datës 25.11.2022 të Kryetarit të



Komunës së Kamenicës, lidhur me refuzimin e kërkesës për pushim pa pagese për përkujdesje ndaj anëtarit të ngushtë të familjes. Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se Kryetari i Komunës së Kamenicës me rastin e refuzimit të kërkesë së saj të datës 11.11.2022 për pushim pa pagesë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-023 për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri, si dhe ka shkelur dispozitat esenciale edhe të Rregullores për Orarin e Punës dhe Pushimin e Zyrtarëve Publik dhe Ligjit për Zyrtarët Publikë, më kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses në tërsi si të bazuar, ndërsa ta anulojë si të kundërligjshëm Vendimin me numër:166/2022 të datës 25.11.2022 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Kamenicës. Këshilli, me datë 26.01.2023 me numër protokoll 935/2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 19.12.2022, me numër protokoll 8192/2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 19.12.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Raportin mjekësor të datës 15.11.2022; Fletë udhëzimin e datës 15.11.2022; Mendimin Koziliar të datës 15.11.2022; Raportin mjekësor të datës 25.11.2022; Raportin e datës 06.12.2022; kërkesën e ankueses të datës 11.11.2022; Vendimin me numër:166/2022 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës i datës 25.11.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 26.01.2022; Përgjigjen e datës 19.01.2022; Raportin e datës 02.12.2022; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Kamenicës i datës 20.12.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në Komunën e Kamenicës, në pozitën: *"Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave"*, e cila sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kamenicës të datës 20.12.2021 ka qenë në pushim të lehonisë që nga data 25.11.2021, mirëpo e njëjta me datë 11.11.2022 ka parashtruar kërkesë te Kryetari i Komunës për pushim pagesë për periudhën kohore një (1) vjeçare me arsyetimin se e njëjta e ka të përkeqësuar gjendjen shëndetësore dhe obligohet t'i nënshtrohet operimit, sikurse ka rekomandim nga pediatri që fëmijës t'i vazhdohet gjidhënia deri në moshën dy (2) vjeçare për shkak të shëndetit jo të mirë të fëmijës.

Kryetari i Komunës së Kamenicës me qëllim të trajtimit dhe shqyrtimit të kërkesës së ankueses të datës 11.11.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër:166/2022 të datës 25.11.2022, duke e refuzuar kërkesën e ankueses me arsyetimin se e njëjta kërkesën për pushim pa pagesë për çështje shëndetësore nuk e ka mbështetur me prova relevante siç përcaktohet me dispozitat Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 16 të Rregullores Rr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, sikurse ka theksuar faktin se ka mungesë të stafit pasi që institucioni ka vetëm një zyrtar për informim dhe monitorim të mediave dhe se punët nuk mund të mbesin pezull.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore lidhur me kërkesën e ankueses për pushim pa pagesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 18 paragrafit 4 Ligjit



Nr.06/L-114 për Zyrтарët Publikë ku përcaktohet se: "4. Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës.", nenit 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ku përcaktohet se: "Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuari të mungojë nga puna pa kompensim të pagës" si dhe nenin 14 paragrafi 1 dhe nenin 16 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.7/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, ku përcaktohet se: "14.1. Zyrtarja publike që ushqen foshnjën me qumësht gjiri i takojnë të gjitha të drejtat sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri; 16.1. Në bazë të kërkesës të zyrtarit publik, udhëheqësi më i lartë administrativ mund të lejojë që zyrtarit publik të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 16.2. Për realizimin e të drejtës për pushim pa pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni, zyrtari publik duhet të paraqet kërkesën e arsyetuar për pushim pa pagesë" dhe ka ardhur në përfundim se zyrtarëve publik, në rastin konkret nëpunësve civil të punësuar në kuadër të shërbimit civil i takon e drejta për pushim pa pagesë nën kushtet dhe rrethanat e përcaktuara me dispozitat e ligjit material si dhe akteve nënligjore.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Kryetari i Komunës së Kamenicës me rastin e nxjerrjes së Vendimin me numër:166/2022 të datës 25.11.2022, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenin 90 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "2. Sigurimi i provave mund të bëhet në cilëndo fazë të procedurës, qoftë edhe para fillimit të saj. Përgjegjësia për të siguruar provat bie në kompetencën e organit publik që udhëheq procedurën administrative." si dhe me nenin 86 paragrafi 1 Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative", pasi që përpara se të refuzoj kërkesën e ankueses të datës 11.11.2022 për pushim pa pagesë, është dashur të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në frymën e dispozitave të lartcekura, duke i kërkuar ankueses që kërkesën e saj ta mbështesë më prova sikurse përcaktohet edhe me nenin 11 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure", ngase në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga ankuesja me rastin e parashtrimit të ankesës së saj në Këshill, e njëjta ka ofruar raportin e datës 07.12.2022 të lëshuar nga ISHP-Instituti i sëmundjeve të mushkërive tek fëmijët "Kozle" në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbi bazën e të cilit konstatohet fakti se fëmija ka nevojë për kujdes në kushte shtëpie nga ana e nënës, dhe po ashtu e njëjta gjendjen e mirë jo shëndetësore e mbështet edhe me raportin mjekësor të datës 15.12.2022 lëshuar nga ISHP-Instituti i sëmundjeve të mushkërive tek fëmijët "Kozle" në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas të cilit fëmija ka përkeqësim të shëndetit në organet e frymëmarrjes. Tutje po ashtu ankuesja kërkesën e saj e mbështet edhe me Raportin Mjekësor të datës 07.12.2022 të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan sipas të cilit fëmija i ankueses ka marr trajtim mjekësor, sikurse ankuesja ka ofruar po ashtu Raportin Specialistik të lëshuar me datë 06.12.2022 nga ISHP SB në Katedra Gjinekologjike Obstetrike në Shkup, me rekomandimin për pushim të rreptë mjekësor dhe këshilla për operim.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës, konstatimit të saktë të gjendjes faktike dhe analizimit të dispozitave ligjore të ligjit material si dhe legjislacionit të punës ka ardhur në përfundimin se Vendimi me numër:166/2022 i datës 25.11.2022 i Kryetarit të Komunës së Kamenicës përmes të cilit ankueses i është refuzuar kërkesa e saj për pushim pa pagesë, është vendim i kundërligjshëm siç përcaktohet më dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën

paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”, dhe mbi këtë bazë vendimi si i tillë është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankueses

është e bazuar në dispozitat e ligjit material dhe mbi këtë bazë Kryetari i Komunës së Kamenicës detyrohet të veprojë në pajtueshmëri me vërejtjet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi me qëllim të zbatimit të drejtë të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe të Rregullores Nr.7/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, duke aprovuar kërkesën e ankueses të datës 11.11.2022 më numër protokoll: 36394 për pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej një (1) viti për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore të saj dhe të fëmijës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nënin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1215/2022

**Rushit KAJTAZI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së